



Ne bazë të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, paragrafi 1, shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 21, të Ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe konform nenit 24, lidhur me nenin 25, paragrafi 6, të Rregullores (QRK), Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E TRAFOSTACIONEVE
DHE DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për vendosjen e trafostacioneve të energjisë elektrike nga KEDS-si dhe dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, për këto fshatrat si më poshtë:

- 1.1 Në fshatin Studençan në parcelën kadastrale **P-72116045-01259-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **2817m²**, sipas certifikatës së pronës **nr. 507-2026**, datës 28.04.2026, zona kadastrale **Studençan**, vendi i quajtur **“Beljua/Çestak”**, e evidentuar në emër të Komuna e Suharekës, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **4m²** për vendosjen e trafostaconit të energjisë elektrike.
- 1.2 Në fshatin Çadrak në parcelën kadastrale **P-72116049-01286-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **9775m²**, sipas certifikatës së pronës **nr. 508/26**, datës 28.04.2026, zona kadastrale **Çadark**, vendi i quajtur **“Kurita Kodra/Rruga”**, e evidentuar pasuri shoqërore e rrugëve (P.SH.E.RRUGËVE), nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **4m²** për vendosjen e trafostaconit të energjisë elektrike.

Neni 2

- 2.1 Pronat e cekura në neni 1, të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë për 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite dhe pas përfundimit të këtij afati të përcaktuar më lartë e drejta e shfrytëzimit të pronës i kthehte Komunës së Suharekës.
- 2.2 Sipërfaqet e pronave të cekura në neni 1, të këtij vendimi jepen në shfrytëzim me pagaes dhe atë nga **0.20€ për m²** (zero presje njëzet cent për meter katror) në muaj për se cilën pron veç e veç, pagesa bëhet në xhirollogarinë Komunës së Suharekës, në fillim të çdo muaj duke filluar prej të parit (1) me së largu deri më të pestin (5) të çdo muaj.

Neni 3

3.1 OBLIGOHET shfrytëzuesi i cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1.1 dhe 1.2, të këtij vendimi, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

3.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

3.3 Komuna e Suharekës e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës për realizimin e interesave publik të Komunës të ndryshoj lokacionin në një vend tjetër.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës së Suharekës, të cilat do të bëjnë parcelizimin dhe skicimin në teren për vendosjen e trafostacionit dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr-_____

Më datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI